



**Kuvendi i Komunës Klinë**

Nr prot. 06-32259/2024

Datë: 29.09 /2024

*Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Me kërkesën e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 06.09.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VIII-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 20.09.2024 mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë për ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi burimor 10 dhe 21
2. Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca (180), nen-programi Infrastruktura Rrugore - Klinë (18018), kodi funksional (0451), nga projektet:
  - “Blerja e kamionit me eskavator për pastrim te ambientit ne Kline”, kodi (54408), shuma **50,000.00** €;
  - “Ndërtimi i sipërfaqeve te gjelbëruara (Parqeve) Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanice, Gllareve, Volljak, Budisalce” kodi (5440), shuma **6,050.81** €

**Rialokohen në projektet:**

  - “Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujerave te zeza ne Zllakuqan, Jashanice, Shtarice, Gllareve, Radulloç, kodi (54516), shuma **20,000.00** €.
  - “Ndërtimi i rrjetit te ndriçimit publik Krushevë e Vogël-Madhe, Drenovc, Qeskove, Jashanice ,Leskoc,Ranoc”, kodi (54353), shuma **30,000.00** €
  - Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt ne Jashanice, Shtupel, Resnik, Kline-Videje, kodi (54354), shuma **6,050.81** €
3. **Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21)**
  - Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjenca (180), nen-programi **Infrastruktura Rrugore - Klinë (18018), kodi funksional (0451), nga projektet:**
  - “Blerja e kamionit me eskavator për pastrim te ambientit ne Kline”, kodi (54408), shuma **30,000.00** €;
  - “Ndërtimi i sipërfaqeve te gjelbëruara (Parqeve) Zajm, Caravik,Poterq,Zllakuqan,Shtupel, Jashanice, Gllareve,Volljak,Budisalce” kodi (5440), shuma **20,000.00** €

**Rialokohen në projektet:**

- Rindërtimi I infrastrukturës mbitokësore me asfalt ne Jashanice, Shtupel, Resnik, Kline-Videje, kodi (54354), shuma 50,000.00 €

**ARSYETIM:** Rialokimi i mjeteve brenda programit bëhet, për t'iu shmangur nënvlerësimit të pasurisë (ngase kamioni duhet t'i dorëzohet kompanisë së Ambientit) dhe për harmonizimin e mjetet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;



*Fadil Gashi*